

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010), nenit 4, paragrafi 4.1, nenit 13, paragrafi 13.1, nënparagrafi (a), ndërlidhur me nenin 15, paragrafi 15.7, nënparagrafi (e), nenin 20, paragrafi 20.1, nënparagrafi (a), dhe nenin 22, paragrafi 22.7, nënparagrafi (e), të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), si dhe në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr. 05/L -116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më datë 29 qershor 2017 miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR KONTROLLET E BRENDSHME DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM
PËR FONDET PENSIONALE

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të sigurojë parimet themelore mbi organizimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme dhe funksionit të auditimit të brendshëm të fondeve pensionale.
2. Kjo Rregullore aplikohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit dhe Pensionet Plotësuese Individuale (në vijim: fonde pensionale) të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:

“Funksioni i auditimit të brendshëm” - nënkupton një aktivitet të pavarur, objektiv dhe këshillues, i themeluar për ngritjen e vlerave dhe përmirësimin e operacioneve të fondit pensional. Ky funksion i ndihmon fondit pensional në arritjen e objektivave duke ofruar një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të rrezikut, të kontrollit dhe proceseve qeverisëse.

“Sistemi i kontrolleve të brendshme” - nënkupton, një proces të ndikuar nga bordi drejtues, menaxherët e lartë dhe personeli tjetër, i themeluar për të ofruar siguri të arsyeshme lidhur me arritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve, mbrojtjen e mjeteve pensionale, besueshmërinë e raportimit dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

“Kompetencë” - nënkupton zotërimin dhe përdorimin e njohurive, aftësive dhe eksperiencës së duhur në ushtrimin e veprimtarisë audituese.

“Integritet” - nënkupton ndershmëri, objektivitet, aftësi dhe shmangie e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit të tyre.

“Pavarësia dhe objektiviteti” - nënkupton se aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur dhe auditorët e brendshëm duhet të jenë objektivë gjatë kryerjes së punës.

“Menaxherët e Lartë” - nënkupton drejtorin menaxhues, zëvendës drejtorin/drejtorët menaxhues.

“Menaxhmenti” - nënkupton personat që nuk janë menaxherë të lartë, por që kanë pozitë udhëheqëse apo kanë në varësi të tyre personat që ata i menaxhojnë.

“Rreziku Operacional” - nënkupton rrezikun që rezulton nga proceset e brendshme të papërshtatshme apo joadekuate të shkaktuara nga njerëzit, sistemet dhe ngjarjet e jashtme. Rreziku operacional përfshin rrezikun ligjor, mirëpo përjashton rrezikun strategjik si dhe atë të reputacionit. Rreziku ligjor përfshin, por nuk është i kufizuar në ekspozimet ndaj gjobave, dënimeve apo masave ndëshkuese, që rezultojnë nga veprimet e mbikëqyrësit, si dhe çdo lloj tjetër i marrëveshjeve me palët individualisht. Edhe pse rreziku i reputacionit dhe rreziku strategjik nuk janë lehtë të identifikueshëm, pritet që fondi pensional të zhvillojnë teknika për menaxhimin e të gjitha aspekteve të rrezikut.

Neni 3

Kërkesat për kontrollet e brendshme

1. Bordi drejtues dhe menaxherët e lartë të fondit pensional duhet të sigurojnë vendosjen e një sistemi të shëndoshë të kontrollit të brendshëm me qëllim të ruajtjes së raportimit të besueshëm financiar, zbatimit të politikave të brendshme, parandalimit të humbjeve, zhvillimit të operimit të matur dhe promovimit të stabilitetit në sistemin financiar të Republikës së Kosovës.
2. Qëllimet e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jenë parandalimi i mashtrimeve, shpërdorimeve dhe veprimeve të gabuara, si dhe zvogëlimi i rreziqeve të tjera të ballafaquara nga fondi pensional, të cilat do të:

- 2.1.sigurojnë zhvillimin e aktiviteteve të fondit pensional në përputhshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe zbatimin e akteve të brendshme, të miratuara nga organet drejtuese të fondit pensional;
 - 2.2.sigurojnë identifikimin, matjen dhe monitorimin e nivelit të rreziqeve, si dhe parandalimin dhe administrimin efektiv të tyre;
 - 2.3.sigurojnë informacion të përshtatshëm, të saktë dhe të besueshëm të gjendjes financiare të fondit pensional, si dhe administrimin sipas procedurave të fondit pensional;
 - 2.4.sigurojnë monitorimin e zbatimit të politikave të fondeve pensionale, duke vlerësuar shkallën e realizimit të objektivave të shprehura në këto politika;
3. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm përbëhet nga komponentët e ndërlidhur në vijim:
 - 3.1.mbikëqyrja nga bordi drejtues dhe menaxherët e lartë;
 - 3.2.njohja dhe vlerësimi i rrezikut;
 - 3.3.kontrolli i aktiviteteve dhe ndarja e detyrave;
 - 3.4.informimi dhe komunikimi; dhe
 - 3.5.monitorimi i aktiviteteve dhe korigjimi i mangësive.

Neni 4

Mbikëqyrja nga bordi drejtues dhe menaxherët e lartë

1. Bordi drejtues dhe menaxherët e lartë janë përgjegjës për mbështetjen e standardeve të larta të etikës dhe integritetit, si dhe sigurojnë që i gjithë personeli të kuptojë rolin e tyre në procesin e kontrollit të brendshëm dhe se do të jenë plotësisht të përfshirë në këtë proces.
2. Bordi drejtues ka përgjegjësinë përfundimtare për të siguruar që menaxhmenti i fondit pensional ka instaluar një sistem kontrolli të brendshëm të mjaftueshëm, efikas dhe efektiv, si dhe vlerëson performansën e sistemit të kontrollit të brendshëm, të paktën një herë në vit.
3. Detyrat specifike të Bordit drejtues në fushën e kontrollit të brendshëm janë:
 - 3.1.aprovimi dhe rishikimi, së paku në baza vjetore, i politikave të rëndësishme të fondit pensional;
 - 3.2.sigurimi i themelimit dhe mirëmbajtjes së një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit të brendshëm, i cili duhet të rishikohet së paku një herë në vit;
 - 3.3.aprovimi i politikave për përcaktimin e kufijve të kompetencave, delegimin e tyre dhe ndarjen e përgjegjësive për punonjësit e fondit pensional;
 - 3.4.aprovimi i politikave të brendshme për monitorimin e rreziqeve dhe vlerësimin e efektivitetit të procedurave dhe metodave për administrimin e tyre;
 - 3.5.sigurimi i mënyrës së raportimit të mangësive (pamjaftueshmërive), të identifikuara në sistemin e kontrollit të brendshëm të fondit pensional;

- 3.6.aprovimi i kodit të etikës dhe aprovimi i politikave apo procedurave për trajtimin të konflikteve të interesit për punonjësit e fondit pensional; dhe
- 3.7.themelimi i komitetit të auditimit sipas kërkesave të nenit 11 të Ligjit nr. 05/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168;
4. Menaxherët e lartë janë përgjegjës për kontrollet organizative dhe procedurale të fondit pensional duke siguruar integritetin e kontrolleve të brendshme dhe duke vendosur një ekip efektiv të menaxhmentin, i cili karakterizohet me një kulturë dhe përgjegjshmëri adekuate;
5. Detyrat specifike të menaxherëve të lartë në fushën e kontrollit të brendshëm janë:
- 5.1.implementimi i strategjisë dhe politikave të aprovuara nga Bordi drejtues;
- 5.2.zhvillimi i proceseve të cilat identifikojnë, masin, mbikëqyrin dhe kontrollojnë rreziqet e shkaktuara nga fondi pensional;
- 5.3.mirëmbajtja e një strukture organizative, e cila në mënyrë të qartë përcakton përgjegjësitë, autoritetin dhe marrëdhëniet e raportimit;
- 5.4.sigurimi që përgjegjësitë e deleguara të përmbushen në mënyrë efektive, vendosja e politikave të duhura të kontrollit të brendshëm dhe monitorimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- 5.5.sigurimi që shërbimet e kontraktuara të çfarëdo lloji të jenë me kompanitë me reputacion të mirë, të cilat kanë një sistem të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm. Kontratat për këto shërbime duhet të përcaktojnë se auditorët e jashtëm, auditorët e brendshëm dhe ekzaminerët e BQK-së do të kenë qasje në çfarëdo lloj dokumentacioni ose burim informacioni ose sistemi që mund të kërkohej në kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse.

Neni 5

Njohja dhe vlerësimi i rrezikut

1. Të gjitha rreziqet materiale të cilat mund të kenë ndikim të pafavorshëm në arritjen e synimeve të fondit pensional duhet të njihen dhe të vlerësohen vazhdimisht. Ky vlerësim duhet të mbulojë të gjitha rreziqet me të cilat përballet fondi pensional (përfshirë rrezikun e investimeve, rrezikun e shtetit dhe të transferit, rrezikun e tregut, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional dhe rrezikun e reputacionit).
2. Kontrollet e brendshme duhet të rishikohen së paku njëherë në vit për të adresuar në mënyrë të duhur ndonjë rrezik të ri dhe të pakontrolluar më parë.
3. Vlerësimi i rrezikut duhet të identifikojë dhe të marrë parasysh faktorët e brendshëm (siç janë kompleksiteti i strukturës organizative, natyra e aktiviteteve të fondit pensional, cilësia e personelit, ndryshimet organizative dhe lëvizjet e stafit) si dhe faktorët e jashtëm (siç janë ndryshimi i kushteve ekonomike, ndryshimet në industri dhe avancimet teknologjike) të cilët mund të cenojnë arritjen e synimeve të fondit pensional.

4. Vlerësimi i rrezikut duhet të kryhet në të gjitha nivelet e aktiviteteve të fondit pensional. Ky vlerësim duhet të adresojë aspektet e matshme dhe jo të matshme të rrezikut dhe duhet të peshojë kostot e kontroleve përkundrejt benefiteve që ato sigurojnë.

Neni 6

Kontrolli i aktiviteteve dhe ndarja e detyrave

1. Menaxherët e lartë duhet të themelojnë një strukturë të përshtatshme të kontrollit, me aktivitetet e kontrollit të definuara në çdo nivel, duke përfshirë rishikime të nivelit të lartë, aktivitete të përshtatshme të kontrollit për departamente dhe njësi të ndryshme, kontroll fizike, kontroll për pajtueshmëri me limitet e ekspozuara dhe përcjelljen e mospajtueshmërisë, një sistem të aprovimeve dhe autorizimeve dhe një sistem të verifikimeve dhe bashkërenditjeve.
2. Aktivitetet e kontrollit përfshijnë themelimin e politikave dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimin se këto politika dhe procedura janë duke u zbatuar.
3. Aktivitetet e kontrollit duhet të përfshijnë të gjitha nivelet e personelit të fondit pensional, prej Drejtorit menaxhues deri te personeli i linjës së parë.
4. Detyrat duhet të shpërndahen në mënyrë të duhur dhe personelit nuk do t'i caktohen përgjegjësitë që mund të rezultojnë me konflikt të interesit. Fushat e konflikteve të mundshme të interesit duhet të identifikohen, minimizohen dhe të jenë subjekt i monitorimit të kujdesshëm, të pavarur, veçanërisht në ato raste që lidhen me aprovimin dhe pagesën e transaksioneve për operacionet e fondeve pensionale, vlerësimin dhe monitorimin e përzgjedhjes së fondeve të investimeve apo institucioneve ku alokohen mjetet pensionale, dhe ndonjë fushe tjetër, ku shfaqen konflikte të theksuara të interesit dhe të cilat nuk janë zvogëluar nga faktorë të tjerë.

Neni 7

Informimi dhe komunikimi

1. Menaxhmenti duhet të mbledhë, regjistrojë dhe mbajë të dhëna të brendshme adekuate dhe gjithëpërfshirëse financiare, operative dhe të pajtueshmërisë, si dhe informacione të jashtme të tregut lidhur me ngjarjet dhe kushtet të cilat janë relevante për vendimmarrje. Informacionet duhet të jenë të besueshme, në kohë dhe të arritshme, si dhe të mbajtura në një format të qëndrueshëm.
2. Sistemet të besueshme të informacioneve duhet të vendosen për të mbuluar të gjitha aktivitetet e rëndësishme të fondit pensional. Këto sisteme, përfshirë ato të cilat mbajnë dhe përdorin të dhëna në formë elektronike, duhet të jenë të siguruara, të mbikëqyrura në mënyrë të pavarur dhe të mbështetura nga planet adekuate në raste emergjente.

3. Menaxhmenti duhet të mbajë kanale efektive të komunikimeve për të siguruar që stafi kupton në tërësi dhe mbështet politikat dhe procedurat të cilat ndikojnë në detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe se informacionet e tjera relevante i komunikohen personelit të duhur.

Neni 8

Monitorimi i aktiviteteve dhe korrigjimi i mangësive

1. Zhvillimi dhe efektiviteti i përgjithshëm i kontrolleve të brendshme të fondeve pensionale duhet të monitorohet në vazhdimësi nga menaxhmenti. Monitorimi i rreziqeve kryesore duhet të jetë pjesë e aktiviteteve ditore. Procesverbalet e mbledhjeve të bordit të drejtorëve duhet të regjistrojnë vendimet e adaptuara lidhur me mangësitë e kontrollit të brendshëm.
2. Fondet pensionale përmes rregullave të brendshme duhet të vendosin linja të qarta të përgjegjësisë për çdo veprimtari. Rishikimi i këtyre rregullave duhet të bëhet në baza vjetore dhe çdo mangësi, duhet të raportohet tek menaxhmenti, komiteti i auditimit dhe bordi drejtues.
3. Kontrolli i brendshëm i fondit pensional plotësohet me auditim të brendshëm, i cili vlerëson sistemin e kontrollit të brendshëm të fondit pensional.

Neni 9

Funksioni i auditimit të brendshëm

1. Auditimi i brendshëm, si një proces dhe veprimtari e pavarur nga pikëpamja e tij vlerëson funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e vendosura të fondit pensional. Procesi i auditimit ndihmon menaxhmentin e lartë dhe Bordin drejtues, për përmbushjen e përgjegjësive të tyre.
2. **Parimet e përgjithshme të funksionimit të auditimit të brendshëm** - Auditimi i brendshëm duhet të ushtrohet dhe mbështetet mbi parimin e:
 - 2.1. **Paanësisë**, i cili nënkupton pasqyrimin objektiv, transparent dhe të vërtetë të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e njësisë publike të audituara, pa u ndikuar nga interesi personal ose pikëpamjet e të tretëve;
 - 2.2. **Integritetit**, i cili nënkupton ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangien e konfliktit të interesave në ushtrimin e veprimtarisë audituese;
 - 2.3. **Pavarësisë dhe objektivitetit**, i cili nënkupton pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë audituese dhe dhënien e mendimeve e gjykimeve objektive gjatë kryerjes së auditimeve;
 - 2.4. **Profesionalizmit dhe ngritjes së vazhdueshme profesionale**, i cili kërkon zbatimin e standardeve me kujdesin e duhur profesional, si dhe përpjekje të vazhdueshme për

formimin dhe zhvillimin profesional, ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të çdo audituesi.

3. Fushëveprimi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të përfshijë:

- 3.1.auditimin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
 - 3.2.rishikimin dhe vlerësimin e implementimit të procedurave për menaxhimin e rrezikut dhe metodologjive për vlerësimin e rrezikut;
 - 3.3.rishikimin e sistemeve të menaxhmentit dhe të informacioneve financiare, përfshirë sistemin elektronik të informacioneve dhe shërbimet elektronike të fondit pensional; rishikimin e saktësisë dhe besueshmërisë së regjistrave të kontabilitetit dhe të raporteve financiare;
 - 3.4.rishikimin e sistemit të fondit pensional për vlerësimin e kapitalit të saj në lidhje me vlerësimin e rrezikut;
 - 3.5.rishikimin dhe vlerësimin e mënyrës së ruajtjes së mjeteve;
 - 3.6.rishikimin e sistemeve të themeluara për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, kodin e sjelljes dhe implementimin e politikave dhe procedurave; dhe
 - 3.7.testimin e besueshmërisë dhe përpikëshmërisë së raportimeve rregullatore dhe kryerjes së detyrave specifike të auditimit të bëhet në baza tremujore.
4. Menaxhmenti është përgjegjës të sigurojë që auditimi i brendshëm të mbahet plotësisht i informuar lidhur me zhvillimet e reja, qofshin ato në tregjet ndërkombëtare financiare apo brenda vendit, performancën e fondeve investive, si dhe ndryshimet operacionale.
 5. Secili fond pensional duhet të ketë një funksion të përhershëm dhe të pavarur të auditimit në mënyrë që të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Bordi i drejtorëve duhet të jetë përgjegjës që të sigurojë pavarësinë e funksionit të auditimit dhe që burimet e mjaftueshme materiale dhe njerëzore të jenë të disponueshme për kryerjen adekuate të funksioneve dhe detyrave të tij.
 6. Funksioni i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e audituara dhe nga proceset ditore të kontrollit të brendshëm. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të ketë autoritetin të komunikojë drejtpërdrejt dhe me iniciativën e tij/saj me bordin drejtues ose përmes komitetit të auditimit, i cili gjithashtu do të vendosë për kompensimin e tij/saj.
 7. Fondi pensional duhet të ketë një statut të shkruar të auditimit që shpreh qëndrimin dhe autoritetin e funksionit të auditimit të brendshëm brenda institucionit, i cili duhet të përmbajë së paku:
 - 7.1.objektivat dhe fushëveprimin e funksionit të auditimit të brendshëm;
 - 7.2.pozitën e udhëheqësit të funksionit të auditimit të brendshëm brenda fondit pensional;
 - 7.3.kompetencat e tij dhe marrëdhëniet me funksionet e tjera kontrolluese; dhe
 - 7.4.përgjegjësinë e udhëheqësit të funksionit të auditimit të brendshëm.

8. Statuti i auditimit dhe çdo ndryshim tij duhet të bëhet me propozim nga komiteti i auditimit dhe aprovohet nga bordi drejtues i Fondeve Pensionale. Statuti i auditimit duhet të rishikohet periodikisht nga funksioni i auditimit të brendshëm.
9. Statuti i auditimit duhet të përcaktojë kompetencën e plotë lidhur me qasjen dhe komunikimin e çdo anëtari ose stafi, të ekzaminojë çdo aktivitet ose njësi, duke siguruar qasje në të dhëna, regjistra, informacione të menaxhmentit dhe procesverbalet e të gjitha trupave konsultativë dhe vendimmarrës, kurdo që është e rëndësishme për kryerjen e detyrave të tij.
10. Statuti duhet të përcaktojë afatet dhe kushtet në të cilat funksioni i auditimit të brendshëm, mund të thirret për të ofruar shërbime konsultative ose këshilluese ose të përmbushë detyra tjera specifike.
11. Anëtarët e funksionit të auditimit të brendshëm duhet të përmbushin së paku cilësitë dhe aftësitë siç janë përshkruar në vazhdim:
 - 11.1. aftësi profesionale për të implementuar dhe përcjellë standardet procedurale dhe teknikat e auditimit;
 - 11.2. njohuri dhe përvojë lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar; dhe
 - 11.3. njohuri të parimeve për administrimin e rreziqeve dhe teknikave prudenciale të auditimit të brendshëm të institucionit financiar.
12. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm do të jetë me reputacion të lartë etik dhe profesional, dhe me një përvojë në fushën e auditimit.
13. Udhëheqësi i funksionit të auditimit duhet të përgatitë një plan të auditimit për caktimin dhe kryerjen e detyrave, i cili do të propozohet nga komiteti i auditimit dhe aprovohet nga bordi drejtues i Fondit Pensionale. Ky plan duhet të përfshijë në detaje kohëzgjatjen dhe shpeshësinë e punëve të planifikuara të auditimit të brendshëm, burimeve të nevojshme për sa i përket personelit dhe duhet të bazohet në një vlerësim të kontrolleve të brendshme dhe mbi një vlerësim të shkruar të rreziqeve materiale të azhurnuar për çdo vit.
14. Raportet e departamentit të auditimit të brendshëm duhet t'i prezantohen komitetit të auditimit, të cilat përmbajnë gjetjet dhe rekomandimet si dhe përgjigjet e menaxherëve të lartë.
15. Raportet dhe letrat e punës duhet të ruhen për së paku pesë vite.
16. Departamenti i auditimit të brendshëm duhet të përcjellë rekomandimet e tij për të verifikuar nëse ato janë zbatuar.

Neni 10
Kontraktimi i auditimit të brendshëm për raste të veçanta

1. Fondi Pensionale për raste të veçanta mund të kontraktojë një profesionist të kualifikuar për të zhvilluar auditimin e brendshëm për fushat dhe aktivitetet specifike, në rastet kur fondi pensional ka deficit të kuadrit profesional apo resurse të specializuara për fushat përkatëse.
2. Pavarësisht nga kushtet kontraktuese, bordi drejtues dhe menaxherët e lartë do të mbesin përfundimisht përgjegjës për të siguruar se funksioni i auditimit të brendshëm është adekuat dhe operon në mënyrë efektive.

Neni 11
Zbatimi dhe masat përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara me nenin 33 të Ligjit për Fondet Pensionale.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci